



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCES-**

Njoftim për shtyp

Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës për procedurat e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos

Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur procedurat e hetimit të thelluar në tregun e çimentos bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 253, datë 03.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar”.

Bazuar në raportin e hetimit, u realizuan seancat dëgjimore me palët, në të cilat Komisioni i Konkurrencës dëgjoi pretendimet e palëve nën hetim në lidhje me raportin e Sekretariatit. Grupi i Punës paraqiti prapësimet e tij pas dëgjimit të pretendimeve të palëve mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e cimentos 42.5 R Rifuxho.

Pas dëgjimit të pretendimeve të palëve nën hetim dhe prapësimeve të Grupit të Punës mbi to, Komisioni i Konkurrencës vendosi se nuk provohet sjellja e koordinuar ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim në kushtet e mungesës së evidencave direkte ose të komunikimit mes palëve prodhuese dhe importuese të produktit cimento rifuxho dhe me thasë nuk mund të evidentohet si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar, ndaj ndërmarrjeve “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY”, SHPK, “ELBASAN FACTORY” SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK.

Gjithashtu Komisioni ka vendosur vazhdimin e monitorimit në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të produktit cimento me rreze 42.5 R..